



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## ***BULETINI DITOR I FSSHM-së***

### ***PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE***

***15 Dhjetor 2015***



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



**MIA**  
AGJENCIA INFORMATIVE E MAQEDONISË

## Drejtorët e FSHM-së e vizituan Spitalin klinik-Tetovë



**Tetovë, 14 dhjetor 2015 (MIA)** - Konfirmimi i buxhetit të ISHP Spitali klinik-Tetovë për vitin e ardhshëm dhe vendosje të metodave të reja me qëllim që avancimit të shërbimeve ndaj pacientëve nga rajoni i Tetovës, ishte qëllimi i vizitës së sotme të punës të drejtorëve të Fondit për Sigurim Shëndetësor Orhan Ramadani dhe Sasho Stefanoski në këtë institucion shëndetësor publik. Ata u takuan me udhëheqësinë e Spitalit klinik-Tetovë i kryesuar nga drejtori Florim Besimi.

Drejtori i FSSHM-së, Stefanoski theksoi se kjo nuk është vazhdim i praktikës së tyre në terren drejtëpërdrejtë për menaxherët e institucioneve shëndetësore që t'i kontrollojnë gjendjet dhe nevojat e tyre.

Spitali klinik-Tetovë, theksoi, është një prej institucioneve më të mëdha shëndetësore dhe pikërisht për këtë arsye sot së bashku me shërbimet profesionale do ta dakordojmë buxhetin për vitin 2016 dhe zbatimin e metodave të reja në vitin e ardhshëm.

"Mbetemi të vendosur për avancim të gjendjeve në shëndetësi për çka kemi katër shtylla - investime serioze në infrastrukturën shëndetësore, aparaturën e re, arsim të vazhdueshëm dhe riarsimim të kuadrit mjekësor në vend dhe jashtë në vend dhe vendosje të gatishmërisë së re organizuese. Të gjithë këto masa kanë për qëllim rritjen e vëllimit të shërbimeve ndaj pacientëve dhe shërbimin e tyre më cilësor", tha Stefanoski.

Drejtori i FSSHM-së, Orhan Ramadani theksoi se Spitali klinik i Tetovës është një prej spitaleve më të mëdha në shtet dhe shërben mbi 127.000 të siguruar të Fondit dhe shtoi se nga viti i ardhshëm pritet vendosja e 46 metodave të reja në punën e tij, që do të merret parasysh gjatë dakordimit të buxhetit për vitin e ardhshëm.**ff/hr/16:02**



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## Në "Alo doktor" javën e kaluar 1.028 thirrje

Javën e kaluar në linjën telefonike "Alo doktor" këshillë mjekësore kanë kërkuar 1.028 qytetarë...



Më së shpeshti këshillë kanë kërkuar për problemet me organet respiratore, temperaturë të rritur, ftohje dhe kollitje të shkaktuara nga moti i ftohtë.

Linja është e qasshme çdo ditë 24 orë dhe në të 25 doktorë janë të qasshëm për këshilla mjekësore. Qëllimi është që t'u mundësohet qytetarëve konsultim i drejtpërdrejtë mjekësor në momentin e paraqitjes së simptomave të ndryshme të prishjes së shëndetit.

Nga fillimi i hapjes së linjës 02/15 123 deri tani në këtë linjë, këshillë mjekësore kanë kërkuar 6.6427 persona./Mia

**PORTALB**  
dritare realiteti

## Tetova, Shkupi, Manastiri dhe Kavadari më të ndotur



Ajri edhe sot është i ndotur në Tetovë, Shkup, Manastir dhe Kavadar. Koncentrimet e grimcave PM 10 të matura gjatë natës në stacionet e matjes në këto qytete lëvizin prej 264 deri 966 mikrogram në një metër kub.

Ajri më i ndotur është në Tetovë, ku disa orë koncentrimet nuk u ulën nën 900 mikrogramë, ndërsa matja maksimale është 966 mikrogramë. Në Manastir gjatë natës koncentrimi maksimal ka arritur 577. Në Shkup ajri më i ndotur ka qenë mbrëmë në Lisiçe me 823 mikrogramë, Qendër 676, Karposh 498 dhe Gazi Babë 446. Në Kavadar gjatë natës koncentrimet e



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË


[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks : 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



grimcave PM 10 kanë arritur 264. Sot në mëngjes ajri më i ndotur është në Tetovë me 342 mikrogramë të matur, në Qendër 297, në Lisiçe 286, Gazi Babë 237, Manastir 199 dhe Kavadar 64 mikrogram në metër kub.

## Gjendje alarmante me ndotjen në Tetovë, sot bojkotohet mësimi (Foto)



Natën mes të hënës dhe të martës ndotja e ajrit ka arritur shifra rekorde, ndërsa sektori civil dhe shumë qytetarë bëjnë thirrje për bojkot të mësimi. Gjatë orëve të mesnatës grimcat PM10 kanë arritur 996 mikrogram për metër kub apo 20 herë më shumë se limiti i lejuar. Njëri nga drejtuesit e Shoqatës EcoGuerrilla, Arianit Xhaferi ka bërë thirrje që të mos dërgohen të martën fëmijët në shkolla,

“Unë nesër nuk e dërgoj djalin tim në shkollë, në vend të tij do shkoj unë. Ju bëj ftesë dhe prindërve të tjerë që kanë fëmijët në shkollën LIRIA që nesër në ora 13:00 të vijnë para shkollës pa fëmijët dhe të takohemi me autoritetet e shkollës. Është për shëndetin e fëmijëve tanë! Presim nga KOMUNA shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme”, ka shkruar Xhaferi në profilin e tij në Facebook.

Thirrje të njëjtë ka bërë edhe Lëvizja “Nëna dhe fëmija”.

“Të nderuar vendosem ad hoc të përkrahin idenë dhe iniciativën e qytetarëve për të bojkotuar mësimin nesër për fëmijët tanë. Gjithë ata që kanë fëmijë në shkollë duhet të përkrahin këtë iniciativë duke mos i dërguar fëmijët në shkollë. Sonte ndotja arriti kulminacionin 996 PM10 dhe akoma jemi në prag të dimrit. Fëmijët tanë nga nesër bojkotojnë mësimin duke mos pranuar të ekspozohen në helmim derisa nuk ka masa konkrete nga pushteti lokal dhe qeveritar. Bashkëngjituni edhe ju. Ti themi jo helmimit.”, shkruan në thirrjen e Lëvizjes



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



së nënave tetovare, njofton SHENJA. Edhe aktivistë tjerë të shumtë dhe qytetarë të Tetovës kanë adresuar thirrje dhe kritika të rënda ndaj funksionarëve nga rajoni i Tetovës. Ata shprehen të mllefosur me gjendjen e krijuar në Tetovë dhe neglizhencën e autoriteteve për të zgjidhur këtë problem.

Si ndotës kryesor të ajrit ekspertët dhe Instituti i shëndetësisë kanë identifikuar fabrikën “Jugohrom”, ndërsa autoritetet qeveritare insistojnë se ajrin e ndotin automjetet dhe drunjtë për djegie.

# Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

## Ndotja në Tetovë arrin kulmin, thirrje të bojkotohet mësimi



Ndotja e ajrit në Tetovës mbrëmë ka arritur shifra alarmante. Gjatë orëve të natës grimcat PM10 kanë arritur 996 mikrogram për metër kub apo 20 herë më shumë se pragu i lejuar. Kjo gjendje ka shkaktuar shqetësim te qytetarët, ndërsa disa nga organizatat qeveritare që merren me çështje të mjedisit kanë ftuar për bojkot të mësimi.

Drejtuuesi i Shoqatës “EcoGuerrilla”, Arianit Xhaferi ka bërë thirrje që fëmijët sot mos dërgohen në shkollë si pasojë ndotjes enorme. “Unë sot nuk e dërgoj djalin tim në shkollë, në vend të tij do shkoj unë. Ju bëj ftesë dhe prindërve të tjerë që kanë fëmijët në shkollën “LIRIA” që sot në ora 13:00 të vijnë para shkollës pa fëmijët dhe të takohemi me autoritetet e shkollës. Është për shëndetin e fëmijëve tanë! Presim nga komuna shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme”, ka shkruar Arianit Xhaferi, një nga drejtuesit e EcoGuerrilla në profilin e tij në Facebook.

Thirrje të njëjtë ka bërë edhe Lëvizja “Nëna dhe fëmija”. Si ndotës kryesor të ajrit në Tetovë ekspertët dhe Instituti i shëndetësisë kanë identifikuar fabrikën “Jugohrom”, por nga ana tjetër në ndotjen e përgjithshme bën pjesë edhe prezenca e shtuar e automjeteve, sidomos atyre të vjetra.



FONDI PËR SIGURIM  
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS  
SË MAQEDONISË

[www.fzo.org.mk](http://www.fzo.org.mk)

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup  
Tel: 02 3289 054  
Qendra: 02 3289 000  
Faks: 02 3289 048  
E-mail: [info@fzo.org.mk](mailto:info@fzo.org.mk)



## ALARM/ Helmi hyn brenda në shtëpitë dhe banesat e tetovarëve



Ndotja e ajrit në Tetovë, sonte ka kapur majat e helmimit, duke vështirësuar frymarrjen dhe duke krijuar gjendje alarmi tek qytetarët. Siç raportohet helmi ka nisur të hyjë edhe nëpër shtëpi dhe banesa ku rrezikon jetën e qytetarëve.

“Ndjehet erë e rëndë në dhomë, frikësohem dua të ikë sepse kam fëmijë të vegjël” shprhet për TetovaSot një banor i trishtuar. Në regjistrimin e sontme të orës 22:44, është regjistruar konctrenimi i grimacave PM10 në 996 mikrogramë në metër kub, njofton TetovaSot.

Ndotja e ajrit në Tetovë është 19.9 herë më e madhe se norma e ndotjes e cila është e lejuar me standardet e Bashkimit Evropian

që është 50 mikrogramë në metër kub./TetovaSot/



## Proteste nga prinderit e femijeve me nevoja te vecanta



**Shkup, 14 dhjetor** – Prindërit e fëmijëve me nevoja të vecanta sot kanë protestuar para qeverisë.

Në kërkesat e tyre drejtuar qeverisë ato kanë kërkuar jetë më të mirë dhe më të begatshme për fëmijët e tyre.

Ato kanë paralajmëruar se mund të përballen me vështirësi akoma më të mëdha por jo me padrejtësi.